



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 18
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 13 qershor 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Faton Topalli dhe Fikrim Damka.

Të ftuar: Fatmir Tasholli, Skënder Lushtaku, Hysen Ajeti, Ndue Kalaj, Sylejman Meta dhe Shaban Kelmendi, përfaqësues të shoqatave dhe sindikatave, mbrojtëse të drejtave të pensionistëve. Rexhep Kaqurri, Musli Mehaj dhe Gëzim Hodolli, përfaqësues të Institutit të Punës Obiliq.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardiane Hasani-KDI, Rita Nushi-KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 08.05.2018 dhe 30.05.2018;
3. Takim me përfaqësues të shoqatave dhe sindikatave, mbrojtëse të drejtave të pensionistëve;
4. Takim me përfaqësues të Institutit të mjekësisë së punës–Obiliq;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 08.05.2018 dhe 30.05.2018;

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 08.05.2018 dhe 30.05.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Takim me përfaqësues të shoqatave dhe sindikatave, mbrojtëse të drejtave të pensionistëve

Kryetarja tha se sot i kemi ftuar përfaqësues të sindikatave mbrojtëse të drejtave të pensionistëve të cilët kanë parashtruar kërkesat e tyre për t'u takuar me komisionin për t'i shprehur shqetësimet e tyre lidhur me ligjin për skemat pensionale të financuar nga shteti, si dhe shqetësimet lidhur me statusin e pensionistëve në Kosovë. Ku të gjithë e dimë se nuk është ai që është dashur të jetë sepse e kemi një sistem pensional, i cili i ka diskriminuar pensionistët të cilët kanë dhënë kontribut për një kohë të gjatë. Dhe kjo e drejtë e juaja është shkelur. Kërkesat e juaja janë të drejta, andaj ju lutem t'i prezantoni shqetësimet dhe kërkesat edhe para komisionit.

Sylejman Meta, kryetar i Federatës së Sindikatës së Pensionistëve e Invalidëve të Punës së Kosovës-FSPIPK, tha se deri me tani s'kemi pasur tretman si duhet si pensionist për këto 20 vjet. Në muajin maj 2018, kemi biseduar edhe me Ministrinë e MPMS-së për çështjen e statusit të pensionistëve në Kosovë. Ne, si federatë, që nga fillimi i hartimit të ligjit për skemat e financuar nga shteti e kemi kundërshtuar më të gjitha format e mundshme. Sepse nga ekspertet tanë kanë konstatuar shumë mangësi dhe nuk është kompatibil as me shtetet e rajonit apo Evropës. Po ashtu nuk janë marrë për bazë propozimet e federatës të dhëna gjatë diskutimit publik. Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti ka mangësi madje është diskriminues në veçanti neni 8 paragrafi 6. Dhe në këtë rast lusim komisionin parlamentar që t'i marrë veprimet e nevojshme apo duke plotësuar pra propozim. U pranohet stazhi i punës të gjithë punëtorëve të dëbuar nga puna sipas ligjit diskriminues të Serbisë nga vitet '90 deri '99 me masat e dhunshëm. Me rastin e privatizimit u njihet e drejta punëtorëve që kanë punuar në tri vitet e fundit. Që do të thotë se punëtorët e sjell pas masave të dhunshme ju takojnë të drejtat lidhur me 20 %, ndërsa punëtorët e dëbuar në mënyrë të dhunshme s'ju takojnë këto të drejta. Ky është një diskriminim i dyfishtë për punëtorët edhe shumë i dëmshëm për Kosovën dhe asetet e saj.

Ndue Kalaj, Sindikata e Pavarur e Administratës së Kosovës -SPAK, tha se ne ju kemi njoftuar për shqetësimet tona edhe me shkrim lidhur me ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti. Që nga viti 2015 kemi krijuar një komision profesional duke e analizuar këtë ligj. Dhe kemi ardhur në përfundim se ky ligj ka përmbajtje diskriminuese dhe i kemi kërkuar Avokatit të Popullit që të hetohen shkeljet e të drejtave të njeriut dhe diskriminimi sipas nesh neni 8, paragrafi 6. Ne kemi shprehur shqetësimet tona se si është e mundur që Kosova pretendon të aderojë në Evropë edhe në këtë rast përmes ligjeve i diskriminon qytetarët e vet. Ky ligj në nenin 8 ka mundësuar trajtim të pabarabartë për të punësuarit e viteve 90-ta. Ju duhet t'i eliminoni këto elemente diskriminuese dhe është ligj kontradiktor. Dispozitat e nenit 8 ua pranon 10 vite stazh kontribut dhënës të gjithë atyre që janë punësuar pas suprimimit të autonomisë së Kosovës. Kurse kategoria e dytë e cila përfiton nga kjo dispozitë është kategoria e të punësuarve të viteve të 90-ta të arsimit dhe shëndetësisë, të cilëve iu pranohen pa i paguar kontributet 10 vjet stazh kontribut dhënës. Kurse kategoria e cila diskriminohet me këtë dispozitë është kategoria e të punësuarve të viteve të 90-ta të cilët u dëbuan dhunshëm nga puna pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, pra futjes së masave të dhunshme, si dhe nxjerrjes së ligjeve diskriminuese. Siç jeni të njoftuar edhe Avokati i Popullit përmes rekomandimit të tij ka vlerësuar se dispozita e nenit 8 është me përmbajtje diskriminuese dhe e pa zbatueshme në praktikë ku përmes rekomandimit ka kërkuar që të amendamentohet ky ligj duke i eliminuar elementet diskriminuese dhe konfuze dhe duke i

harmonizuar me dispozitën e nenit 3 të Kushtetutës së Kosovës e cila qytetarëve ju garanton barazi të plotë. Andaj kërkojmë nga ju që sa më parë t'i ndërmerri hapat konkret në amendamentimin e këtij ligji sa më parë. Dhe nëse nuk ndërmerren hapat konkret ne do t'i njoftojmë ambasadorët e vendeve të kuintit se Kosova po i diskriminon qytetarët e vet përmes ligjit dhe do të padisim qeverinë dhe parlamentin për shkelje të drejtave të njeriut e cila nuk është e mirë për ne. Dhe shumë shpejt do të dalim në protestë para Qeverisë dhe para Kuvendit.

Hysen Ajeti, përfaqësues i sindikatës së ish- policeve të Kosovës, tha se edhe ne kërkojmë që sa më parë të ndryshohet neni 8, paragrafi 6 i këtij ligji i cili është diskriminues. Kemi njerëz që shkojnë me 75 euro në pension edhe pse ka punuar disa vite pra për disa ditë nuk i përmbush 15 vite stazh dhe shkon në pension me 75 euro. Edhe punëtorëve të shëndetësisë s'po ju pranohet të gjithëve ky stazh edhe pse shkruan në ligj. Shprehja të tjerëve. Kemi dyshime se po keqpërdorët pra po kemi favorizime për disa persona. Ne kemi dy rekomandime nga Avokati i Popullit një rekomandim vetëm për sindikatën e ish- policeve dhe një rekomandim për të gjitha kategoritë. Andaj ju lutem të veproni sa më parë në amendamentimin e këtij ligji.

Shaban Kelmendi, Federata e Pensionisteve të Kosovës, tha se u thanë të gjitha se i përket ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti se është diskriminues. Mirëpo unë me tepër do të shprehu shqetësimin time sa i përket çështjes apo vendimit të Strasburgut dhe rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i ka nxjerrë rekomandimet për MPMS-në me formuar komisionin shtetëror për përgatitjen e shënimeve për pensionistet edhe për t'i dërguar në Strasburg. Komisioni i ka përgatitur shënimet dhe i ka përcjellë në ministri. Ministër ka qenë z. Nenad Rashqi. Propozimi i komisionit ka qenë të formohet fondi pensional. Të dorëzohen shënimet në gjykatën e Strasburgut, në komitetin për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit të Strasburgut. Ministria nuk i ka kryer këto obligime. Komiteti në Beograd për zbatimin e vendimit të Strasburgut i ka prite shënimet, listën e pensionisteve. Ministria neve si federatë nuk na ka dhënë shënimet për t'i proceduar më tej me arsyetimin se nuk jemi të autorizuar. Strasburgu i ka nxjerrë tri vendime. Një vendim për t'i paguar pensionet prej periudhës kur i kanë ndalur me gjithë borxhin, si dhe e ka dënuar Serbin me ka 10 000 euro për secilin pensionist. Vendimi tjetër e ka obliguar Serbinë që t'i paguajë 130 000 punëtorë të larguar në mënyrë të dhunshëm nga puna. Vendimi i tretë e ka obliguar Serbinë që t'i paguaj kursimet që i kanë pasur qytetarët që i kanë pasur nëpër banka në atë kohë. Fondi Republikan i Serbisë ka kërkuar nga UNMIK që t'i dërgojë shënimet për pensionistet. UNMIKU ka kërkuar nga MPMS –ja që t'i dërgojnë shënimet dhe këta nuk i kanë përcjellë. Kosova është duke kërkuar nga Serbia që t'i transferojë mjetet në buxhet të Kosovës, Serbia nuk i ka borxh Kosovës, por qytetarëve, pensionisteve. Ne e kemi paditë Kosovën-Ministrin në gjykata për mos dhënie të shënimeve informatave për pensionisteve. Gjykata e ka obliguar ministrinë që të na jap shënimet në mënyrë që t'i procedojnë me tej. Ligji për pensionet duhet harmonizohet dhe të themelohet fondi pensional në Kosovë. Pra, ne kemi dy kërkesa një që të themelohet fondi pensional dhe të kthehen mjetet nga fondi pensional i Serbisë.

Flora Brovina tha se ju përkrahim sa ju përket kërkesave të sindikatave dhe në këtë rast distancohem nga politika pensionale që është zhvilluar në Kosovë se ka qenë politike diskriminuese prej fillimit. Duke marrë ekspertë nga jashtë të cilët fare nuk e kanë njohur çështjen e Kosovës dhe pikërisht nga Suedia të cilët kanë ndikuar në ligjet e para të pensioneve. Pensionistet prej atëherë deri me sot janë të diskriminuar. Qysh atëherë ja kam thënë ministrin të MPMS se ky ligj është diskriminues sepse i favorizon ata që kanë ardhur si pushtues, ndërsa i shkel ata që pa të drejtë janë përjashtuar nga puna dhe për këtë arsye ju përkrahu dhe i mbroj të drejtat e juaja. Edhe unë jam njeri nga mjeket e para që jam përjashtuar nga puna në mënyrë të dhunshme nga forcat policore të Serbisë. Ne duhet të punojmë bashkërisht që kjo temë të

diskutohet edhe në Kuvend dhe kjo e drejtë e garantuar edhe nga gjykata e Strasburgut të realizohet. Ju si sindikata duhet të shprehni shqetësimet e juaja edhe tek presidenti i Kosovës këtë çështje.

Fatmire Kollçaku tha se e njëjta temë që nga viti 2004 po diskutohet edhe sot thujse nuk ka lëvizur fare asnjë gjë. Shteti merr obligim për qytetaret e vet. Sllovenia këtë çështje e ka marrë obligim vetë, mandej më bisedim i kanë zgjidhe kontestet me Serbinë. Ky nen është shumë diskriminues dhe nuk ka diskutabile kjo çështje. Askush me dëshirë nuk e ka lëshuar punën, por është përjashtuar në mënyrë të dhunshme dhe nuk duhet shteti që të harrojë sakrificën e këtyre punëtorëve. Nuk duhet të favorizohet vetëm kategoria e arsimit edhe unë e angazhuar në Shoqatën e Nenës Terezë nuk e gëzoj këtë të drejtë sot. Me këtë sistem të tanishëm, siç është trusti, shumë vështirë është të grumbullosh mjete që kur të dalësh në pension të jetosh dinjitetshëm. Në këtë rast është shteti që të vendos se çfarë sistemi do të marrë apo donë sistem gjenerata për gjeneratën në këtë rast parimi i solidaritetit. Sa i përket vendimeve të Gjykatës së Strasburgut shteti duhet të angazhohet që t'i marrë veprimet që të zbatohen dhe qytetarët t'i gëzojnë të drejtat e tyre lidhur me pensionet dhe kursimet. Duhet të rishikojmë këtë ligj dhe të ju njihet të gjithë qytetarëve stazhi pensional.

Enver Hoti tha se mirë që po diskutojmë këtë çështje. Ju potencuat z. Meta, se kemi pasur marrëveshje para fushatës elektorale marrëveshje që e ka mbledhur votën dhe e ka gjuajtur këtë marrëveshje. Kurse z. Kelmendi, tha se kemi vendim të Gjykatës së Strasburgut që është penguar falë bisedimeve në Bruksel. Përfaqësuesit e juaj të sindikatave shpesh bëheni apo manipuloheni një pjesë apo individ të caktuar nga partitë politike dhe në këtë rast të gjithë jemi fajtor për këtë çështje. Duhet të këtë vullnet politik të shefave të partive politike që të ndryshohet kjo dispozitë e cila është diskriminuese. Ajo se çka është duke punuar MPMS në reformën e skemave pensionale aty është mirë që të gjithë të japim kontributin në këtë reformë. Unë mund të ju garantoj se do të punojmë fuqishëm që t'i qasemi ndryshimeve të këtij ligji. Unë kam vërejtur se sindikatat nuk janë në funksion të mbrojtjes se të drejtave të 1% punëtorëve, keni dalë nga roli juaj.

Haxhi Avdyli tha se edhe ne ju përkrahim në kërkesat e juaja dhe do t'ju përkrahim. Të diskutohet sot për këtë gjendje është turp për gjitha institucionet si për qeverinë dhe Kuvendin. Kur e marrim parasysh se me çfarë zelli kjo qeveri ka për t'i ngritur pagat e veta, ndërsa për njëmijë punëtorë të policisë që janë përjashtuar nga puna në mënyrë të pa drejtë nuk ka koment. Mendoj se dështimet janë të gjithëve dhe një nga dështimet më të mëdha është se nuk është shfrytëzuar dialogu në të kaluarën që kjo çështje të zgjidhet. Ne ju përkrahim në kërkesat e juaja dhe bashkërisht do të trajtojmë sa më parë këtë çështje dhe ne, si shtet, ju kemi hyre në hak ju si pensionistë dhe në çdo moment jemi të gatshëm të ju përkrahim në realizimin e kërkesave tuaja.

Bekim Haxhiu tha se edhe disa ditë më parë kemi diskutuar sa i përket reformës në skemat pensionale, po ashtu edhe disa here në Kuvend e kemi ngritur si shqetësim për këtë që ju e keni ngritur si shqetësim sot. Është bërë e pa drejtë e madhe, e në veçanti sektorëve që kanë dhënë kontribut të madh në vitet 90-ta. Pajtohemi plotësisht me ju që policet që i janë bashkëngjitur popullit dhe kanë braktisur vendet e tyre të punës sot janë të diskriminuar ndërsa ata që kanë vazhduar që të punojnë me sistemin sot i gëzojnë të drejtat pensionale se i kanë plotësuar stazhin prej 15 viteve. Pra, jemi para dy mundësive me një ndryshim plotësim të shpejtë të ligjit bashkërisht me ministrinë që të ju mundësohet njerëzve të drejtat që ju takojnë po të presim deri në fund të vitit me reformat pensionale në përgjithësi. Pra, këtë dilemë duhet të qartësojmë me MPMS se do të veprojmë më tej. Pra ne duhet të ftojme ministrin dhe të pajtohemi se si do t'i qasemi kësaj çështje më shpejt.

Kryetarja tha se ju falënderojmë të gjithë për kontributin. Ne do të ftojme ministrin e MPMS-së dhe do të diskutojmë lidhur me këto shqetësime dhe bashkërisht do të vendosim se si do t'i qasemi kësaj problematike. Ne do të pyesim ministrin se kur do të bëjë këtë reforme të skemave pesnionale dhe nëse kjo çështje zgjatë ne, si komision, kemi mundësi që të kërkojmë që të amendamentohet ky ligj të cilin edhe ne e vlerësojmë se duhet të ndryshohet dhe është diskriminues. Ne do të jemi në kontakt dhe do të punojmë bashkërisht që kjo çështje të përfundoje sa më parë.

4. Takim me përfaqësues të Institutit të mjekësisë së punës–Obiliq

Kryetarja tha se sot po ashtu kemi ftuar përfaqësues të institutit të punës së Obiliqit për t'i dëgjuar shqetësimet e tyre dhe për të parë mundësinë se çka mund t'i mbështesim në kërkesat e tyre.

Rexhep Kuquri tha se Instituti i Mjekësisë së Punës-IMP funksionon nga vitet e 60-ta, aktivitetet primare i të cilës ka qenë mbrojtja dhe kujdesi i shëndetit të të punësuarave pra vizitat sistematike, vizitat preventive-kurative, certifikata shëndetësore për punësim, gjithashtu shërbimet tona i kanë shfrytëzuar banorët e rajonit. I gjithë aktiviteti i IMP-së është zhvilluar në kuadër të Koorporatës Elektro-Energjetike të Kosovës-KEK. Me procesin e ristrukturimit të KEK-ut në vitin 01/04/2006, IMP është detyruar të regjistrohet si shoqëri aksionare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Kjo gjendje dita ditës po rëndohet dhe aktualisht përballemi me rrezikun e shuarjes së veprimtarisë sonë. Andaj po ju drejtohem me këto kërkesa. Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq, ta inkorporojë në sistemin shëndetësor shtetëror të Republikës Kosovës, përkatësisht në Ministrinë e Shëndetësisë. Aktualisht në IMP, janë të punësuar janë 81 punonjës me përgatitje profesionale. Doktor shkence 2 punonjës, Specialist të Mjekësisë së Punës 5 punonjës, specialiste të lëmimeve tjera 14, si Neuropsikiatër, ORL, oftalmolog, stomatolog, gjinekolog, pulmolog, Internist, fiziatër, radiolog, biokimist, sociolog, psikolog, me përgatitje të lartë 8 punonjës infermier dhe asistent të mjekëve 39, si dhe staf mbështetës 13. Gjatë amendamentimit të ligjit për shëndetësi shpresojmë se mjekësia e punës do të këtë vendin e saj dhe në këtë rast kërkojmë mbështetjen tuaj që edhe ne, si institut, të jemi pjesë e sistemit shëndetësor.

Gëzim Hodolli tha se IMP ka një eksperiencë të madhe dhe mund të dhamë një kontribut të veçantë e në këtë rast po theksoj se përveç veprimtarisë mjekësore në IMP, specifike e veçantë është Shërbimi për Mbrojtje nga Rrezatimi Jonizues dhe jo jonizues dhe Higjienën e Punës, i cili është i vetmi departament në nivel vendi, që afron shërbime për mbrojtje nga rrezatimi që nga viti 1978 në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ky shërbim bën matjen e rrezatimit në ajër, ujë, tokë dhe ushqim, kontrollin e cilësisë dhe sigurisë nga aparatet e rëntgenit (dhe burimet radioaktive) në mjekësi dhe industri, dozimetrinë personale etj. Kohëve të fundit po kemi problem në qasje në projekti për arsye se jemi shoqëri aksionare. Kështu që inkuadrimi i jonë në ministrinë e shëndetësisë do të japë kontribut të madh në afrimin e shërbimeve.

Musli Mehaj tha se në këtë vit e kemi vitin jubilar 55 -vjetorin e themelimit të IMP-së. Ne kemi pritur se do të kemi raportin e komisionit ndërministror i cili ka dhënë rekomandim unanim se IMP të kalojë në kuadër të ministrisë së shëndetësisë. U theksua se në IMP afrohen shumë shërbime ku asnjë institucion nuk i afron. Preokupim i vazhdueshëm i ynë ka qenë dhe mbetet bashkëpunimi dhe përfshirja e IMP-së në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Jemi të bindur që IMP i plotëson të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Shëndetësi dhe Udhëzimin Administrativ për Organizimin dhe Veprimtarinë e Mjekësisë së Punës për të qenë Institut i

Mjekësisë së Punës në kuadër të sistemit shëndetësor publik të Kosovës. Në bazë të ligjit çdo i punësuar është i obliguar që të kryej vizitën sistematike të mjeku i punës.

Kryetarja tha se me ligjin aktual të shëndetësisë është e vërtetë se nuk jeni pjesë e SHSKUK, përveç që është Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës e Gjakovës. Unë shikova web-faqen tuaj, por nuk pash se keni web funksional dhe të dhënat që tregojnë për organizimin dhe shërbimet që i afroni. Kurse Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës e Gjakovës kishte të dhëna që prezantojnë organizimin e saj dhe shërbimet që afrohen. Ne momentin që do të shqyrtojmë ligjin për shëndetësi ne do të trajtojmë me theks të veçantë dhe këtë institut mos të lëmë anash. Pra, është një institut i cili me të vërtetë është mesë i domosdoshëm që duke ditur se në çfarë rrethanash punojnë dhe fatkeqësitë që po ndodhin në vazhdimësi. Pra, ne duhet të analizojmë se a është e nevojshme jo në këtë rast vetëm në Gjakovë dhe Obiliq, por edhe në të gjitha qendrat tjera të kemi institutin e punës. Ne do të kemi parasysh shqetësimet e juaja dhe do të bashkëpunojmë ngushte gjatë shqyrtimit të ligjit për shëndetësi.

Rexhep Kaqurri tha se web-faqen se kemi funksional në mungesë të buxhetit për arsye se edhe pagat ne pothuajse nuk i marrim 100 %. Dhe për këtë arsye nuk kemi mundësi që të dizajnojmë dhe mirëmbajmë web-faqen e IMP-së.

Bekim Haxhiu tha se sa i përket IMP-së gabimi ka qenë institucional, pra kur është bërë riorganizimi i KEK-ut si ndërmarrje publike detyrimisht është dashtë të kemi marrëveshje të institucioneve që mjekësia e punës në atë periudhë kohore të transferohej në një institucion publik pasi që më lehtë do të ishte sistemimi i juaj në Ministrinë e Shëndetësisë. Sot e kemi me vështirë që një shoqëri aksionare duhet me sistemuar në kuadër të sistemit publik shëndetësor, pra duhet të analizojmë aspektin ligjor. Kapacitete që i ka IMP kanë mundur që të përdorën në të mirë të kujdesin e shëndetit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së tij. Në këtë rast disa organizata shëndetësore i kanë kryer kontrollet mjekësore shkel e shko sa për t'i përmbushur këtë obligim ligjor e kanë dëmtuar edhe IMP edhe kemi pasur pasoja të atyre që nuk i kanë kryer ato kontrole mjekësore si duhet. Me ligjin e shëndetësisë duhet të parashohim themelimin e qendrës kombëtare të mjekësisë së punës. Po ashtu ka pasur mungesë të planifikimeve të specializimeve për mjekësin e punës. MSh asnjëherë s'ka pasur një planifikim të qartë të kuadrove që na mungojnë me qëllim që t'i planifikojnë specializimet me qëllim që më vonë të mos mbesim me mungesë të kuadrove. Ne duhet të shohim mundësin e sistemimit të IMP në kuadër të sistemit publik shëndetësor bashkërisht edhe me Ministrinë e Shëndetësisë.

Musli Mehaj tha se IMP e ka themeluar KEK-u para 50 viteve kjo është arsyeja pse nuk kemi qenë pjesë e institucioneve shëndetësore. Deri në vitin 2006 kemi qenë në rregull Fakulteti i Mjekësisë e ka pas barrën e specializimeve. Mirëpo pas riorganizimit të KEK-ut ka ndodhur kjo problematikë. I vetmi institucion shëndetësor se është profitabil për arsye se gjenerojmë të hyra për kryerje të shërbimeve shëndetësore sistematike nuk do të jetë barrë e buxhetit për kundër do të sjellë buxhet shtesë buxhetit.

Flora Brovina tha se po diskutojmë për një institucion shumë të rëndësishëm për shërbimet që i afrohen. Mirëpo më reformën në shëndetësi nuk është parapara për shkaqet që u theksuan. Në të kaluarën kemi pasur një mbrojtje e të mirë të punëtorëve si rezultat i këtij instituti dhe ai i Trepçës këto institucione kanë bërë edhe përcjelljen e sëmundjeve, siç është cilikoza, ndërsa sot po na paraqiten edhe sëmundje tjera për ne të panjohura në lëmin e mjekësisë së punës. Me rastin e reformës apo ligjit të shëndetësisë nuk pasur mirëkuptim që të shuhet ky institucion i juaj dhe të

ndërtohet një institucion i mirëfilltë bashke me atë të Gjakovës dhe Trepçës dhe me lëmit tjera cilat nuk ekzistojnë sepse nuk është vetëm rrezatimi, por edhe ngarkesa psikike për shkak të stresit të orarit të zgjatur të punës, si dhe mos funksionimit të ligjit për mbrojtje në punë. Nuk është vetëm mjekësia e punës që është lënë anash, por kemi edhe mjekësin shkollore, mjekësin sportive etj. Me ndryshimin e ligjit për shëndetësi do të kemi parasysh që të rregullojmë edhe çështjen e mjekësisë së punës.

Haxhi Avdyli tha se ne në kuvendin e Kosovës kemi zhvilluar disa debate parlamentare në këtë rast edhe për të drejtat e punëtorëve ku kemi diskutuar për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Mirëpo kur të vjen punë kur IMP ka të bëjë direkt me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, pra ne duhet të afrojmë përkrahje dhe të bëjmë zgjidhje rreth statusit të IMP. Në diskutimin time për ndotjen unë e kam ngritur çështjen, pra fuqizimin e Institutit, si dhe të ngritet ndonjë spital special për trajtimin e pasojave të ndotjes. Me kontratën për Contour Global ne kemi nënshkruar kontratën dhe si Kosovë kemi hyrë në obligime edhe për 30 vjet, ku do të kemi pasoja me ndotjen. Në ligjin për shëndetësi do të shqyrtojmë këtë vit sipas agjendës legislative dhe do të trajtojmë me theks të veçantë edhe çështjen e mjekësisë së punës. Ne bashkërisht duhet të punojmë për fuqizimin e institutit të mjekësisë së punës.

Fatmire Kollçaku tha se çështja e rregullimit të IMP varet nga vullneti politik dhe ne si profesionistë shëndetësorë duhet t'i udhëzojmë se si duhet të veprohet në rregullimin e kësaj problematike. Ka ndodhur një gabim pas luftës se me konceptin e mjekësisë familjare me kaluar shumica e kompetencave te mjeku familjar, mirëpo është harruar se nuk është interes mbrojtja e të drejtave të punëtorëve me qëllim të joshjes se investitorëve të jashtëm. Ne gjithë jemi dëshmitarë me fatkeqësitë me punëtorët që po ndodhin dhe jo të punohet në preventiv përmes kontrollet sistematike. Përcaktimi i invaliditetit dhe lëndimeve të punës nuk mund të jete kompetence e mjekut familjare, por e mjekut të punës. Unë mendoj se është gabim në shuarjen e mjekësisë së punës, por duhet t'i zhvillohet dhe kushtohet një vëmendje në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Unë jam për të rregulluar dhe fuqizuar sa më parë këtë problem me ligjin e punës.

Enver Hoti tha se është bërë gabim në momentin e ristrukturimit të KEK-ut dhe besoj se ka pasur një qëllim në shndërrimin e IMP-se në shoqëri aksionare në atë kohë sepse ju e dini se punëtorët e institucioneve janë të obliguar në kryerjen e vizitave shëndetësore obliguese, siç janë Policia e Kosovës, FSK-ja, si dhe shumë punëtorë të tjerë të institucioneve dhe është menduar se do të jenë të obliguar të gjithë në kryerjen e vizitave shëndetësore tek ju dhe të këtë me lehet nën menaxhim si shoqëri aksionare! Mirëpo ja që ne këtë kohë po keni shumë telashe dhe janë krijuar edhe institucione të tjera dhe këto vizita po kryhen te këto dhe ju keni vështirësi në qëndrueshmërinë financiare si institut i mjekësisë së punës. Këtë po e them edhe si ish pjesëtar i TMK-së dhe kur kemi ardhur që t'i bëjmë vizitat tek IMP-ja. Fatkeqësisht kemi ardhur në një gjendje jo të mirë. Ne s'kemi para që kompanitë private sipas legjislacionit i kanë sjellë punëtorët në kontrollet shëndetësore te mjekësia e punës. Ne jemi të përkushtuar që të ju ndihmojmë dhe që IMP të merr rolin dhe luaj funksionin në mbrojtjes së punëtorëve, si dhe në parandalimin e sëmundjeve profesionale, sepse jemi duke u ballafaquar mjaft shumë dhe në këtë rast as nuk kemi marrë masa parandaluese në sëmundjet profesionale si rezultat i kushteve të rënda të punës.

Rexhep Kaquri the se ne kemi kërkuar nga ministria e shëndetësisë se a kemi protokoll për sëmundjet profesionale. Ne nuk kemi ende si Kosovë këtë protokoll. Ne këtë rast kërkojmë nga inspektorati i punës që t'i kryej detyrat e veta, pra kontrollet e rregullta nëpër kompanitë dhe ne këtë rast kompanitë do të detyrohen që t'i dërgojnë punëtorët e tyre në kontrollet e rregullta shëndetësore.

Flora Brovina tha se unë propozoj që si komision parlamentar t'i vizitojmë Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq, si dhe Trepçën. Dhe të kemi një pasqyrë më të mirë ndoshta edhe të organizojmë një debat parlamentar në Kuvend.

Komisioni shqyrtoj propozimin e deputetes Flora Brovina dhe e përkrahu që në të ardhmen të realizoj vizitë punë në këto institucione dhe nga afër të njihet me punën dhe problematikat që po ballafaqohen.

Kryetarja tha se ne, si komision, gjatë shqyrtimit të projektligjit për shëndetësi do të shqyrtojmë kërkesat e juaja dhe do të bashkëpunojmë ngushtë në zgjidhjen e kësaj problematike.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU